



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
Prokuroria e Apelit / Apelaciono Tužilaštvo / Appellate Prosecution

Raport statistikor i Prokurorisë së Apelit për muajin Shkurt 2025

Të dhënat e mëposhtme paraqesin informata për lëndët e trajtuara sipas departamenteve gjatë muajit shkurt 2025:

Departamenti i Krimeve të Rënda

Numri i përgjithshëm i lëndëve të ndryshme (PPA- ankesa kundër aktgjykimeve, PPN – ankesa kundër aktvendimeve, PAR – ankesa kundër masave të sigurisë dhe AKAP – ankesa kundër aktvendimit të prokurorit për hushje të kallëzimeve penale, pushim të hetimeve dhe për mosndërmarrje të veprimeve nga ana e prokurorit), të pranuar në Departamentin e Krimeve të Rënda gjatë muajit shkurt është gjithsej 264 lëndë të ndryshme + 2 lëndë të bartura nga muaji i kaluar, gjithsej 266 lëndë, kemi kryer 260 lëndë dhe 6 lëndë kanë mbetur të pa kryera:

- PPA.I – 66 lëndë
- PPN.I – 51 lëndë
- PAR.I – 122 lëndë
- AKAP.I – 25 lëndë + 2 lëndë të bartura nga muaji i kaluar, gjithsej 27 lëndë, të zgjidhura 18 lëndë, ndërsa të pazgjidhura 9 lëndë.

Sa iu përket lëndëve AKAP – ankesa kundër aktvendimit të prokurorit për hushje të kallëzimeve penale, pushim të hetimeve dhe mosndërmarrje të veprimeve nga ana e prokurorit janë pranuar 25 lëndë, të bartura nga muaji i kaluar 2 lëndë, gjithsej 27 lëndë: të kryera janë 18 lëndë dhe të pa kryera janë 9 lëndë.

Mënyra e kryerjes, si në vijim:

- Të hedhura si të paafatshme - 1 lëndë;
- Të refuzuara janë - 11 lëndë;
- Të aprovuara janë - 6 lëndë.

Departamenti për të Mitur

Numri i përgjithshëm i lëndëve të ndryshme (PPAM, PPNM, PARM dhe AKAPM), të pranuar në Departamentin për të Mitur është 60 lëndë, 1 lëndë e bartur nga muaji i kaluar, e që shuma e tërësishme e lëndëve është 61 lëndë, e po ashtu të përfunduara janë 61 lëndë.

- PPAM – 22 lëndë;
- PPN.M – 5 lëndë;
- PAR.M – 32 lëndë;
- AKAP.M – 1 lëndë e pranuar dhe 1 e bartur nga muaji i kaluar.

Departamenti i Përgjithshëm

Departamenti i Përgjithshëm gjatë muajit janar 2025 ka pranuar 556 lëndë të ndryshme (PPA, PPN, PAR dhe AKAP), si dhe të bartura nga muaji i kaluar janë 6 lëndë, e që shuma e tërësishme është 562 lëndë, ndërsa janë kryer 547 dhe kanë mbetur pa kryer 15 lëndë.

- PPA.II – 243 të pranuar, 232 lëndë të kryera, si dhe 8 lëndë të pakryera;
- PPN.II – 125 lëndë të pranuar dhe të kryera;
- PAR.II – 150 lëndë të pranuar dhe të kryera
- AKAP.II – 38 lëndë + 6 të bartura nga muaji i kaluar, gjithsej 44 lëndë, 37 lëndë të zgjidhura dhe 7 lëndë kanë mbetur të pazgjidhura.

Departamenti i Përgjithshëm - AKAP.II

Sa iu përket lëndëve AKAP – ankesa kundër aktvendimit të prokurorit për hudhje të kallëzimeve penale, pushim të hetimeve dhe mosndërmarrje të veprimeve nga ana e prokurorit janë pranuar 37 lëndë, si dhe 6 lëndë të bartura nga muaji i kaluar, gjithsej 43 lëndë, të përfunduara janë 35 lëndë dhe 8 lëndë kanë mbetur të pakryera.

Mënyra e kryerjes:

- Të hedhura si të paafatshme – 1 lëndë;
- të refuzuara – 22 lëndë;
- të aprovuara – 12 lëndë.

RLN - Regjistri i lëndëve me kërkesë nga prokuroritë themelore dhe Prokuroria Speciale – Lëndë për Zgjidhjen e Konfliktit të Kompetencës.

- Regjistri RLN ka pranuar 2 lëndë dhe 2 lëndë të mbetura nga muaji i kaluar, gjithsej 4 lëndë të përfunduara.